



NDAJI PËRJETIMET

UDHËZIM PËR INSTALIM TË RUTERIT (PAJISJE PËR QASJE TË INTEGRUAR) DHE MEDIA MARRËSIT

UDHËZIM PËR INSTALIM TË RUTERIT (PAJISJE PËR QASJE TË INTEGRUAR) DHE MEDIA MARRËSIT

Edicioni: prej 07/2019

Na kontaktoni:

Në dyqanin më të afërt Telekom

Kontakt qendra tel: 122

Biznis kontakt qendra tel: 120


telekom.mk

Botues:

Telekomi i Maqedonisë


"Kej 13 Nëntori" nr. 6

1000 Shkup




NDAJI PËRJETIMET

LIDHJA E RUTERIT (PAJISJE PËR QASJE TË INTEGRUAR)



LIDHJA E MEDIA MARRËSIT



*Pamja e pajisjeve tuaja mund të ndryshojë nga ato në fotografitë e udhëzimit.

HAPI 1:

Lidhni ruterin.

Lidhni ruterin me DSL ose lidhësen optike me kabllo përkatëse. Pastaj lidhni ruterin në prizën elektrike dhe kyçni ndërprerësin në anën e pasme nëse e posedon. Fillon konfigurimi automatik dhe llampat led të pajisjes fillojnë të vezullojnë. Pritni derisa llampat të fillojnë të ndriçojnë në kontinuitet.

HAPI 2:

Lidhni telefonin në ruter.

Kyçni telefonin në ruter duke pasur kujdes tek shenjat e ruterit dhe ato të telefonit.

HAPI 3:

Lidhni kompjuterin në internet.

Që të lidhni kompjuterin në internet shfrytëzoni kyçjet LAN 1 ose LAN 2, ose lidhuni pa tel nëpërmjet rrjetit WiFi. Emri i rrjetit (SSID) dhe fjalëkalimi (WPA key) gjenden në pjesën e pasme ose pjesën e poshtme të ruterit.

HAPI 4:

Lidhni media marrësin.

Lidhni media marrësin me kabllo rrjetore në portat LAN 3 ose LAN 4 të ruterit.

HAPI 5:

Lidhni televizorin me media marrësin.

Ju rekomandojmë që media marrësin ta lidhni në HDMI lidhësen e televizorit.*

*Në pajisje janë në dispozicion edhe mënyra tjera të lidhjes: scart, S-Video, RGB dhe të ngjashme, varësisht nga modeli i marrësit.

HAPI 6:

Kyçni media marrësin.

Kyçni media marrësin në prizën elektrike dhe kyçni ndërprerësin në pjesën e prapme. Zgjidhni hyrjen përkatëse të televizorit dhe pritni të përfundojë konfigurimi dhe të paraqitet fotografia në televizor.

Për më shumë informacione, merrni udhëzimin përkatës sipas modelit. **



**UDHËZIME PËR RUTERË
(PAJISJE PËR QASJE TË INTEGRUAR)**

<https://www.telekom.mk/upatstva-uredi-integriran-pristap-ruteri.nspk>



UDHËZIME PËR MEDIA MARRËS

<https://www.telekom.mk/upatstva-medija-priemnici-maxtv.nspk>

**Informacione për modelin e ruterit ose media marrësit mund të gjeni në etiketën në pjesën e pasme ose të poshtme të pajisjes. Deri te udhëzimet mund të keni qasje edhe nëpërmjet aplikacionit Telekom mk - në dispozicion në Google Play dhe App store (<https://www.telekom.mk/telekommk-app.nspk>).

PËR TË GJITHA PROBLEMET KËTU ËSHTË TEKNIKU YNË VIRTUAL
(www.telekom.mk/virtualtechnician.nspk)



Zgjidhni shpejtë dhe lehtë pengesën e linjës tuaj, në çdo kohë të ditës ose natës, duke e shfrytëzuar Teknikun virtual.

Nuk ka nevojë për telefonatë në Kontakt qendër, sepse Tekniku virtual kontrollon linjën tuaj dhe nëse has në ndonjë problem e zgjidh vetëm me disa klikime.

Është në dispozicion nëpërmjet aplikacionit **Telekom MK** ose në <https://mojtelekom.mk>.

